

## KAZUS

1. Z. Marel Kolan, i lindur më 1975, emigroi nga Demetru për në Herios, ku takoi, Znj. Lera Xiang, e lindur më 1978 me të cilën u martua dhe nga martesë patën 3 fëmijë, Amadeo, i lindur më 1999, Kleofan, i lindur më 2001 dhe Preos, e lindur më 2003. Në kërkim të një jete më të mirë, pas martesës dhe lindjes së fëmijës së parë çifti u transferua në Ares (vend i botës së tretë), ku jetoi për katërmbëdhjetë vjet.

2. Në një datë të papërcaktuar, çifti dhe fëmijët e tij u larguan nga Ares drejt shtetit të Volanës me anije, dhe prej këtej u transferuan në Hestia<sup>1</sup>. Me të mbërritur në këtë shtet, më 18 korrik 2013 iu nënshtruan menjëherë procedurës së identifikimit. Pasi u zbulua se kishin dhënë identitete të rreme, babai i familjes Z. Kolan u ndalua për 10 ditë, ndërkohë që nëna dhe tre fëmijët e tjerë u vendosën në një strukturë pritëse, ku qëndruan deri në datë 28 korrik 2013, moment që përkoi me përcaktimin e identiteteve të vërteta të azilkërkuesve.

3. Duke qenë se në këtë shtet fluksi i emigrantëve ishte tepër i lartë, po në këtë datë, familja u transferua në një Qendër Kujdesi në një komunë tjetër, ku për shkak të mungesës së ambienteve babai dhe djali i madh u strehuan në një godinë dhe nëna me dy fëmijët e tjerë në një godinë tjetër. Kushtet e strehimit në Qendër ishin tepër të këqija, ku në një hapësirë prej 20 m<sup>2</sup> bashkëjetonin mesatarisht 9-10 persona, dyshekët nuk plotësonin kushtet minimale higjienike, kishte mungesë të instalimeve të nevojshme si dhe kishte vetëm një banjë të përbashkët për të gjithë. Për më tepër mes personave në pritje kishte dhe grindje që derivonin në dhunë.

4. Në 30 korrik 2013 familja Kolan u largua pa leje nga Qendra dhe më 2 gusht ata mbërritën në shtetin Vista ku iu nënshtruan sërish procedurës së identifikimit, dhe nga shqyrtimi dhe krahasimi i shenjave të gishtërinjve rezultoi se familja Kolan kishte qenë e regjistruar në Hestia. Për këtë arsye më 7 gusht 2013, u refuzua kërkesa e tyre për azil, dhe po atë ditë iu paraqit një kërkesë autoriteteve hestiane për të marrë përgjegjësinë e kërkesës për azil. Më datë 19 gusht 2013 shteti hestian pranoi zyrtarisht kërkesën.

5. Në një datë të pacaktuar, familja Kolan lëvizi drejt shtetit Agleja. Më 16 nëntor 2013, shërbimet vistiane njoftojnë shtetin hestian për anulimin e transferimit, pasi kërkuesit ishin zhdukur.

6. Në 5 nëntor 2013 familja Kolan kërkoi azil në Agleja.

7. Në 17 nëntor 2013 një polic civil, E.K., i kishte kërkuar Z. Marel Kolan kartën e identitetit, por ky i fundit kishte refuzuar t'ia dorëzoi dokumentin pa parë paraprakisht letërnjoftimin që e identifikonte E.K. si polic. Si kundërveprim, polici e kishte marrë me dhunë dhe dërguar në rajonin më të afërt policor, ku ishte vendosur në një dhomë me të proceduar të tjerë. Z. Marel Kolan kishte vazhduar me protestën e tij për arrestimin e padrejtë dhe i nxitur nga kjo sjellje E.K. e kishte marrë në zyrën e tij dhe e kishte goditur mizorisht në fytyrë dhe bark. Një ditë më pas, pasi u identifikua se kishte ardhur si azilkërkues, Z. Marel Kolan u la i lirë.

8. Në momentin e largimit nga rajoni i policisë, E.K. e paralajmëroi Z. Kolan se gjatë shqyrtimit të kërkesës së tij për azil do të paraqitej raporti i policor për rezistencën e bërë ndaj zyrtarit publik, sjelljes abuzive dhe kërcënimeve verbale, pavarësisht se të gjitha këto ishin fiktive.

9. Gjatë intervistës, familja Kolan deklaroi se kushtet në Hestia ishin tepër të vështira, nuk përmbushnin kushtet minimale për jetesë dhe se u ishte dukur e pamundur mundësia për gjetjen e një vendi pune për të mbijetuar. Në vazhdimësi të intervistës ata kishin parashtruar këto arsye: (a) Z. Kolan nuk i kishte dorëzuar dokumentet e identifikimit policit E.K., sepse ai

---

<sup>1</sup> Shtet anëtar i BE

nuk i kishte ato me vete, duke qenë se nga Ares ishin larguar me ndihmën e një kontrabandisti, të cilit i kishte paguar 20 mijë dollarë, dhe si garanci për dhënien e lekëve në momentin e largimit nga vendi i tij i kishte mbajtur dokumentet e tij të identifikimit.; (b) Lidhur me raportin e policisë se Z. Kolan kishte shfaqur sjellje abuzive gjatë kësaj periudhe të shkurtër, Z. Kolan nuk i pranoi akuzat dhe për më tepër ai paraqiti para autoriteteve, raportin mjekësor që e kishte kryer direkt pas lirimit, nga ku provohet se ai kishte patur “nxirje në faqen e majtë” dhe “nxirje në bark”. Z.Kolan kërkoi edhe një ballafaqim me E.K., por ky i fundit nuk pranoi ballafaqim dhe e mohoi verbalisht se kishte ushtruar dhunë.; (c) Arsyeja pse ndiheshin të rrezikuar në Ares ishte se djali i tyre i madh kishte hyrë në një marrëdhënie homoseksuale si dhe praktikonte kultin “Higo”, i cili ishte i ndëshkueshëm penalisht në vendin e origjinës. Familja Kolan pretendonte se jeta e Amadeos dhe familjes do të vihej në rrezik në rast kthimi.

10. Më një vendim të datës 26 janar 2014, Autoriteti për Migracionin Aglejan nuk e pranoi kërkesën e Kolanëve për azil dhe urdhëroi kthimin e tyre në Hestia, me arsyetimin se: “kushtet e vështira në Hestia, apo prirja homoseksuale e djalit nuk ishin një arsye e fortë, e tillë që të mund të vinte në rrezik jetën e Kolanëve në rast kthimi në këtë shtet. Pra, nuk u takonte autoriteteve aglejane të zinin vendin e Hestias, pasi ky shtet kishte nënshkruar një marrëveshje të posaçme për marrjen e përgjegjësive për kërkesat e azilit, që e bënte përgjegjës për shqyrtimin e kushteve të azilkërkuesve”.

11. Përmes një akti të datës 5 shkurt 2014, familja Kolan iu drejtua Gjykatës Administrative Aglejane ku kërkuan anulimin e vendimit të Autoritetit për Migracionin dhe argumentuan se kushtet e pritjes së azilkërkuesve në Hestia shkelnin nenin 3 të Konventës dhe për më tepër, Hestia pas veprimit të tyre, “arratisjes”, kishte probabilitet të lartë që t’i rikthente ata në vendin e origjinës çka rrezikonte që familja të binte viktimë e persekutimit apo edhe e rrezikut për jetën e tyre. Për këtë arsye ankesa e tyre duhej rishqyrtuar dhe njëherë duke i mbajtur në konsideratë këto detaje.

12. Me një vendim të datës 17 shkurt 2014, Gjykata Administrative e rrëzoi apelimin, duke lënë në fuqi vendimin e Autoritetit për Migracionin me arsyetimin se: “Pavarësisht pretendimeve të palës se mekanizmat e pritjes dhe ndihmës kishin mangësi lidhur me marrjen e azilkërkuesve në ngarkim për shkak të ngarkesës, nuk mund të mos prezumohej se shteti i Hestias i respektonte detyrimet e tij ndërkombëtare”.

13. Lidhur me sjelljen e familjes Kolan, gjykata u shpreh se ata nuk iu kishin dhënë mundësi autoriteteve hestiane për të shqyrtuar mundësinë për rregullimin e situatës”. Kështu familja Kolan gëzonte garancinë se me të mbërritur në Hestia, kërkesat e tyre do të shqyrtoheshin nga autoritet vendase.

14. Në të njëjtën ditë Z. Kolan, u mor në paraburgim, pasi u verifikua se ai kishte gënjyer lidhur me arsyen e mungesës së dokumenteve të identifikimit, pasi ato i ishin mbajtur nga shteti Vista. Kjo masë u mor me qëllim sigurimin e zbatimit të këtij vendimi dhe “parandalimin e arratisjes së tij”. Ai u vendos në të njëjtin ambient ku u ndalua herën e kaluar, ndërkohë që bashkëshortja dhe tre fëmijët e tjerë u vendosën në një qendër strehimi për azilkërkues.

15. Më 1 mars 2014 Autoriteti për Migracionin kishte planifikuar transferimin e familjes për në shtetin Hestia.

16. Më 1 mars 2014 në orën 9:25, avokati i Z. Kolan i kishte bërë kërkesë Këshillit të Mosmarrëveshjeve për të Huajt, ku kërkonte anulimin e urdhrin për të larguar familjen nga vendi bashkë me një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit sipas procedurës së përsheptuar.

17. Seanca u planifikua po atë ditë në orën 11:30 ku avokati i kërkuesit nuk ishte prezent në seancë dhe për këtë arsye kërkesa për pezullimin e ekzekutimit u refuzua.

18. Z. Kolan refuzoi të hipte në avion me familjen më datën e caktuar, dhe për këtë arsye rihyri në fuqi urdhri i tij për ndalim bazuar në Ligjin për të Huajt. Familja u vendos sërish në Qendrën e strehimit.

19. Më 6 mars 2014 autoritetet hestiane dërguan një dokument standard ku deklarorin se ishte përgjegjësi e tyre të shqyrtonin kërkesën e Z.Kolan për azil. Dokumenti përmbylej me fjalinë: “Këta persona nëse dëshirojnë mund të paraqesin kërkesë sapo të mbërrijë në Hestia”.

20. Me një vendim të datës 20 mars 2014, Këshilli i Mosmarrëveshjes për të Huajt, hodhi poshtë kërkesën për anulimin e largimit nga vendi, pasi familja Kolan nuk e kishte paraqitur kërkesën për vazhdimin e procedurës brenda afatit 15 ditor nga dhënia vendimit të refuzimit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit, të depozituar sipas procedurës tejet urgjente.

21. Lidhur me këtë vendim nuk pati asnjë ankesë administrative.

22. Kolanët u njoftuan më 21 mars 2014 se largimi i tyre do të kryhej më datë 25 mars. Pas këtij njoftimi Z. Kolan depozitoi një kërkesë të dytë në gjykatë, përmes të njëjtit avokat për anulimin e urdhrin për largimin e familjes së tij nga territori. Ai sërish e mbështeti kërkesën, në rreziqet me të cilat do të përballej nëse kthehej në Hestia dhe ato me të cilat do përballej nëse kthehej në Ares, për shkak të probabilitetit të ulët për marrjen në shqyrtim dhe aprovimin e kërkesave të tij, duke qenë se ankimi administrativ që mund të ngrihej para autoriteteve hestiane nuk ka efekt pezullues ndaj urdhrin të dëbimit. Gjithashtu ai paraqiti dhe një ankesë për dhunën e ushtruar nga polici civil EK. Bashkangjitur kësaj kërkesë ishte edhe raporti i mjekut të përgjithshëm.

23. Transferim i dytë u realizua më 25 mars 2014 dhe këtë herë familja ishte e shoqëruar. Me të mbërritur në tokën Hestiane, Z. Kolan, së bashku me familjarët dorëzuan deklaratën e lëshuar nga shteti hestian.

24. Në 29 mars 2014 avokati i Z. Kolan u njoftua se ai ishte ndaluar pas dorëzimit të deklaratës për azil, ishte ndarë nga familja e tij dhe ishte vendosur në një ndërtesë afër aeroportit, i kyçur në një hapësirë të vogël me 35 persona të tjerë, ku duhej të shkonte në tualet me orar, nuk i lejohej të dilte për ajrosje, kishte shumë pak ushqim dhe kishte fjetur në dysheme. Po ashtu ai ishte rrahur nga oficerët e policisë.

25. Kur u lirua më 28 mars 2014 atij iu dha karta e azilkërkuesit, iu kërkua deklarimi i adresës së banimit me qëllim që të informohej në lidhur me ecurinë e kërkesës së tij për azil, por nuk iu dha asnjë informacion për vendndodhjen e pjesëtarëve të tjerë të familjes.

26. Pas lirim, Z.Kolan nuk kishte raportuar në polici vendndodhjen, pasi nuk kishte mundur të gjente familjen dhe në këto kushte kishte jetuar në park së bashku me disa azilkërkues të tjerë. Më 1 prill Kancelarja e Gjykatës (X) të shtetit aglejan i dërgoi letër qeverisë hestiane ku kërkonte që autoritetet hestiane të informonin autoritetet aglejane lidhur me vazhdimësinë e kërkesës së azilkërkuesit për azil.

27. Më 2 maj 2014 qeveria hestiane kthen përgjigje se Z. Kolan së bashku me familjen e tij arriti në aeroportin e Telos (Hestia) më 25 mars 2014, dhe se ai kishte aplikuar për azil e po ashtu kishte filluar procedurat për familjarët e tij, por pas lirim nga ndalimi, ai nuk ishte paraqitur në Rajonin e Policisë, për të dhënë adresën e tij dhe për të mbajtur korrespondencë.

28. Në fakt ai nuk kishte asnjë adresë për të dhënë.

### ***Ngjarjet pasardhëse***

29. Më 5 maj 2014, në përpjekje për të lënë shtetin e Hestias, Z. Kolan u arrestua në aeroport për posedimin e një kartë të rreme identiteti.

30. Ai u izolua shtatë ditë në të njëjtin rajon afër aeroportit, ku ishte mbajtur edhe pas ndalimit të parë. Në një mesazh drejtuar avokatit të tij, ku përshkruante kushtet e ndalimit, deklaroi se ishte rrahur nga oficerët e policisë të qendrës, dhe se donte të bashkohej me familjen e tij dhe të largohej nga Hestia ose në të kundërt të qëndronin me kushtin, që të mos jetonin në kushte të tilla të vështira.

31. Më 7 maj 2014 ai u dënua nga Gjykata Penale e Hestias me tre muaj burgim, në përpjekje për t'u larguar nga vendi me dokumente false.

32. Më 8 maj 2015, kërkuesi përmes avokatit të tij bëri apelim ndaj vendimit, duke e bazuar në një urdhër të nxjerrë nga Ministria e Rendit "Mbi hyrjen, rezidencën dhe integrimin social të shtetasve të vendeve të treta në Hestia", duke pretenduar se situata e tij nuk kishte qenë objekt i një shqyrtimi të thelluar dhe se Z. Kolan ishte subjekt i një procedure administrative dëbimi. Kjo kërkesë iu transferua nga Gjykata Penale e Apelit, Gjykatës Penale të Shkallës së Parë, e cila e ricilësoi atë si një "kërkesë për rishikim". Kërkuesi u lirua pasi nuk u konsiderua se kishte qëllim të arratisë dhe se nuk përbënte kërcënim për rendin publik. Por, shteti hestian kishte marrë vendim për largimin e familjes Kolan nga vendi pas gjithë shkeljeve të njëpasnjëshme.

33. Ndërkohë, pjesa tjetër e familjes Kolan kishin bërë një kërkesë me shkrim në gjykatë dhe një argumentim të hollësishëm, duke e lidhur me të drejtën e tyre për të qëndruar në Hestia, me faktin e prirjeve dhe praktikimit të kultit "Higo" nga Amadeo Kolan, fëmijët kishin filluar shkollën aty etj. Me anë të një letre të datës 12 maj 2014, të regjistruar në Sekretarinë e gjykatës në datën 17 maj, Z. dhe Znj. Kolan i kërkuan gjykatës të urdhëronte autoritetet hestiane të pezullonin riatdhesimin e tyre në Ares, për sa kohë zgjaste procedura.

34. Më 20 maj 2014 Familja Kolan rinovoi kartat e tyre rozë<sup>2</sup> dhe për gjashtë muaj të tjerë.

35. Më 22 qershor 2014 vendimi për dëbimin e familjes Kolan ishte revokuar automatikisht nga autoritetet hestiane pasi kërkesa për azil ishte bërë si nga ana e familjes ashtu dhe nga Z. Kolan pikërisht para arrestimit të tij.

36. Në një letër të datës 28 qershor 2014, Ministria e Mirëqenies Sociale informoi Këshillin Shtetëror Ligjor që, për shkak të kërkesave të shumta, kërkimi për familjen Kolan ishte vonuar, por ata ishin gjetur; në mungesë të një adrese ku mund të kontaktoheshin të gjithë së bashku, nuk kishte qenë e mundur informimi i tyre.

37. Më 22 nëntor 2014 Familja Kolan morën një njoftim në gjuhën hestiane, të cilin ata e nënshkruan në prani të një përkthyesi, dhe me të cilin thirreshin për një intervistë në Qendrën e policisë në Hestia, më 27 nëntor 2014. Familja Kolan nuk mori pjesë në intervistë.

38. I kontaktuar nga avokati i tyre, pas seancës dëgjimore para Gjykatës, familja Kolan e informoi atë se njoftimi i ishte dorëzuar atyre në gjuhën hestiane, kur karta e tyre rozë ishte rinovuar dhe se përkthyesi nuk kishte përmendur ndonjë datë për intervistë.

39. Në një mesazh drejtuar avokatit të tyre të datës 8 janar 2015, Znj. Lera e informoi atë se Z. Kolan kishte tentuar edhe një herë të largohej nga Hestia. Ai ishte ndaluar nga policia dhe më pas së bashku me familjen ishin dërguar në kufirin Aresian për dëbim. Në momentin e fundit, sipas deklaratës së Znj. Lera Kolan, policia hestiane vendosi të mos i dëbojë, për shkak të pranisë së policisë aresiane.

#### **PYETJE:**

Cilat të drejta të mbrojtura nga Konventa Evropiane për Drejtat e Njeriut mund të pretendojnë kërkuesit se u janë shkelur?

---

<sup>2</sup> Leje qëndrimi për azilkërkuesit